

ALBANIAN LANGUAGE IN SCHOOL TEXTBOOKS GJUHA SHQIPE NË TEKSTET SHKOLLORE

Idaete SINANI¹

¹* *Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje*

^{*}*Corresponding author e-mail: idaetesinani@hotmail.com*

Krijimi i një gjuhë letrare kombëtare për të gjithë shqiptarët ishte njëri nga idealet më të mëdha të Rilindjes sonë kombëtare. Prandaj, breza të tërë lëvruesish e studiuesish të gjuhës, arsimtarësh e atdhetarësh, kanë punuar e janë përpjekur pareshtur për një gjuhë letrare e për një drejtshkrim të njësuar.⁹⁸ Rilindja Kombëtare, por edhe përfshirja e të gjithë intelektualëve deri tek njerëzit e thjeshtë që e donin gjuhën si ushqim i shenjtë për zemrën dhe mendjen, bëhen pjesë e një mekanizmi që në kulmin e tij kishte realizmin e hapjes së shkollës shqipe.

Mësonjëtorja e parë kishte një vlerë të çmuar simbolike, por edhe reale, duke u mishëruar si një institucion ku fjala e shkruar shqipe do të mësohej dhe gjuha do të standardizohej duke filluar nga shpirtrat e mitur, të dëlirë e të lirë, të më të vegjëlve tanë. Vendosja e një alfabeti të vetëm pas Kongresit të Manastirit, ishte një hap i rëndësishëm përpara në këtë rrugë. Si rrjedhojë e kësaj, formimi i gjuhës letrare kombëtare, themelet e së cilës ishin hedhur që në kohën e Rilindjes, ishte një fitore e madhe e popullit shqiptar si fryt i përpjekjeve të shumta në punën dhe luftën e pandërprere për ngritjen e vetëdijes gjuhësore të popullit tonë.

Jemi në vitin 2022 dhe këtë vit do të shënohet 50-vjetori i organizimit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që paraqet një jubile të madh të gjuhës sonë standarde shqipe. Në trashëgiminë tonë kulturore, në gjuhën tonë, në aftësinë krijuese të shqiptarëve, gjendet zemra e identitetit tonë, e vetë kombit që ka ekzistuar shumë kohë më përpara themelimit të shtetit. Çdo komb ka të shënuara momentet kur historia kujton data të rëndësishme që lidhen me identitetin kulturor, shpirtëror dhe kombëtar. Ky proces i kujtesës dhe i festimit, ka një rëndësi të dyfishtë, duke rivlerësuar dhe nxjerrë në pah në këndvështrim strategjik, idenë e gjuhës dhe të kulturës letrare që e ushqen këtë gjuhë – si akt thelbësor i identitetit të një populli.⁹⁹

⁹⁸ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë, 1973 f. 4.

⁹⁹ Eris Rusi, *Trashëgimia letrare e Naim Frashërit dhe identiteti kulturor shqiptar*, Konferencë shkencore mbarëshqiptare kushtuar 130-vjetorit të Mësonjëtores së Parë Shqipe, 130 vjet Mësonjëtorja e Parë Shqipe – vatër e arsimimit, emancipimit dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare, Korçë, 6 Mars 2017, f. 231.

50 vjet më parë, delegatë nga të gjitha trojet etnike të shqipes dhe nga diaspora arbëreshe, përfaqësues të shquar të shkencës filologjike, të letrave e të kulturës shqiptare, të mbledhur në një kuvend kombëtar, morën një vendim historik: njohën rezultatin e zhvillimit shekullor konvergjent të shqipes dhe kodifikuan normën e saj letrare, duke i dhënë shqipes fytyrën e një gjuhe moderne të njësuar.¹⁰⁰ Edhe pse ka kaluar një gjysmëshekulli, Kongresi i Drejtshkrimit, vazhdon të mbetet ngjarje me rëndësi themelore në historinë e kombit shqiptar dhe përbën gurin e themelit të kaheve të reja të njësimi gjuhësor, kulturor e shpirtëror të shqiptarëve në të gjitha trojet e veta etnike dhe në diasporat e hershme e të reja në botë.¹⁰¹

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe asokohe ndaj gjithë opinionit shkencor e shoqëror shqiptar, shtroi përgjegjësi dhe detyra të cilat duhej të zbatoheshin për të ecur në rrugën e njësimi sa më të plotë të drejtshkrimit të gjuhës sonë e për të zgjidhur një varg çështjesh të vështira e të ndërlikuara. Me drejtshkrimin e njësuar e normën letrare kombëtare, “Puna për përvetësimin dhe zbatimin me përpikëri të drejtshkrimit doli në plan të parë. Detyra të mëdha u shtruan në mënyrë të veçantë përpara shkollës shqiptare, vatrës themelore të formimit gjuhësor të brezave të rinj.

Përvetësimi e zbatimi tërësor i këtij drejtshkrimi kishte nevojë të ndihmohet edhe nga një punë metodike e gjerë dhe e organizuar, sidomos në shkollën tetëvjeçare, ku kërkohej një përvetësim krijues i drejtshkrimit, në pajtim me moshën dhe me njohuritë e përgjithshme gjuhësore të nxënësve.¹⁰² Kongresi “shprehu besimin e tij të plotë se kjo thirrje do të përkrahet me entuziazëm dhe do të frymëzojë arsimtarët, shkrimtarët, punonjësit e shkencës dhe kulturës, gjithë inteligjencën dhe të gjitha masat punonjëse, që me veprimtarinë e tyre krijuese ta zhvillojnë, ta pasurojnë e ta ngrenë gjithmonë më lart gjuhën tonë letrare kombëtare”.¹⁰³

Arsimi shqiptar i të gjitha niveleve e ka për mision të mbrojë kulturën gjuhësore të shqiptarëve mbi bazën e zgjidhjeve shkencore që ka vënë Kongresi i Drejtshkrimit, sepse niveli gjuhësor i një shoqërie është tregues edhe i nivelit të saj kulturor dhe i qytetërimit të saj. Gjuha shqipe është lënda kryesore që ndikon në zhvillimin intelektual, shoqëror, estetik dhe emocional të nxënësve. Ajo i pajis nxënësit me njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime, të cilat janë përcaktuese jo vetëm për arritjet e tyre në çdo fushë dhe lëndë mësimore, por edhe për të qenë të suksesshëm në botën përtej shkollës. Duke qenë kaq e rëndësishme në jetë, gjuha shqipe është trajtuar si e tillë edhe në programet mësimore të shkollës.¹⁰⁴

Por, edhe pse kanë kaluar pesë dekada, dhe shqipja standarde ka arritur t’u bëjë ballë stuhive të shumta të kohës dhe funksionon më së miri, duhet të pranojmë se për rrethana jashtëgjuhësore, prestigji i saj është tronditur. Nuk na lejohet të mbyllim sytë, kur shohim përditë një shkujdesje të pafalshme për kulturën e gjuhës, kur shohim përditë se shkelet norma leksikore dhe vërshojnë pa fre fjalë të huaja të panevojshme, se shkelet norma drejtshkrimore, dhunohen trajtat morfologjike dhe struktura sintaksore e shqipes, se shëmtohet pamja e saj. Aq më keq kur shohim, se niveli i përvetësimit të shqipes në shkollë ka rënë tek s’mban.¹⁰⁵

Prandaj, me ndjenjën e një përgjegjësie të thellë ndaj detyrave që shtroi Kongresi i Drejtshkrimit ndaj neve, opinionit shkencor e shoqëror shqiptar si dhe duke u nisur nga rëndësia që kanë tekstet shkollore në procesin e informimit, arsimimit dhe edukimit të nxënësve, në këtë punim do të trajtojmë gjuhën shqipe në tekstet shkollore të arsimit fillor me mësim në gjuhën shqipe, me theks të veçantë tekstet shkollore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

¹⁰⁰ Akademia jubilarë me rastin e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, Universiteti “Fan S. Noli”, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, Korçë, 2012, f. 17.

¹⁰¹ Gjovalin Shkurtaj, *Kahet e reja të kulturës së gjuhës shqipe mbas Kongresit të Drejtshkrimit, Propozime për drejtshkrimin (1976-2014)*, ITSHKSH&SHGJSH, Shkup, 2022, f. 272.

¹⁰² *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë, 1973 f. 12.

¹⁰³ Po aty f. 27.

¹⁰⁴ Udhëzues kurrikular lëndor për gjuhën shqipe, Material ndihmës për mësuesit e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Tiranë, 2018.

¹⁰⁵ http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/fakulteti_edukimit/akademia_solemne.pdf.

Të mësosh e ta vlerësosh gjuhën shqipe, ta shkruash bukur dhe drejt gjuhën e popullit tënd, është diçka më tepër se patriotizëm. Por, në kushtet e teknologjisë e informacionit, zhvillimit të internetit e rrjeteve sociale, të vjen seriozisht keq, kur konstaton se në ç'nivele të ulëta është katandisur mësimi dhe shkrimi i gjuhës shqipe në shkolla. Realiteti flet për faktin se një përqindje e mirë e nxënësve nuk dinë ta shkruajnë dhe ta flasin siç duhet gjuhën standarde shqipe. Duke vlerësuar se tekstet shkollore janë burimi kryesor i nxënies së standardit gjuhësor, kemi trajtuar aspekte dhe problematika të procesit të nxënies së gjuhës standarde shqipe përmes teksteve shkollore kryesisht të ciklit fillor.

Gjatë analizës së teksteve janë identifikuar përmbajtje problematike të teksteve, shkarje dhe gabime të shumta që në vlerësimin tonë, paraqesin vështirësi në rrugën e nxënies dhe përvetësimit të standardit gjuhësor nga ana e nxënësve. Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë mbështet edhe ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndëve të tjera. Në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit fitojnë njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar me gojë dhe me shkrim; lexojnë dhe kuptojnë tekste të llojeve të ndryshme; pasurojnë fjalorin dhe botëkuptimin e tyre duke lexuar tekste letrare dhe joletrare; mësojnë të shkruajnë tekste të ndryshme (opinionë, raporte, udhëzime etj.); mësojnë ta përdorin drejt nga ana gramatikore dhe drejtshkrimore gjuhën etj.

Të gjitha këto njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime, sigurojnë suksesin e nxënësve edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Nga ana tjetër, edhe lënda e gjuhës shqipe lidhet dhe integrohet me lëndët e tjera. Integrimi ndërlëndor shmang marrjen e njohurive të fragmentuara dhe të shkëputura nga jeta e përditshme.¹⁰⁶

Gjuha shqipe dhe gjuhët e huaja. Shumë studime tregojnë se po që se nuk e di bukur ta flasësh e ta shkruash gjuhën amtare, nuk mund ta mësosh mirë një gjuhë të huaj. Prandaj gjuha standarde shqipe, mbetet parakusht për të mësuar dhe studiuar gjuhët e huaja.

Gjuha shqipe dhe matematika. Shkrimi njësh i numërorëve themelorë që nga njëmbëdhjetë deri më nëntëmbëdhjetë, i numërorëve që tregojnë dhjetëshe, qindëshe, si edhe i numërorëve rreshtorë, pavarësisht nga numri i pjesëve përbërëse të tyre. Shkrimi ndaras i numërorëve themelorë, të formuar me pjesëmarrjen e fjalëve mijë, milion, miliard etj., dhe i pjesëve përbërëse të një numërori themelor, të lidhura me lidhëzën e. Shkrimi i numërorëve rreshtorë me shifra arabe, shkrimi i numërorëve rreshtorë me shifër romake,¹⁰⁷ shkrimi i thyesave dhe shumë çështje tjera që lidhen me shkencën e matematikës, nuk do të kishin kuptim nëse nuk mësohen e shkruhen në formën e duhur. Por, edhe pse është punuar dukshëm në ngritjen e nivelit të teksteve shkollore, përsëri mund të evidentohen lëshime e gabime si teknike ashtu edhe drejtshkrimore, gramatikore e leksikore. Gabimet që kemi hasur më së shumti janë drejtshkrimi i gabuar i numrave, thyesave, i njësive matëse, trupave gjeometrikë etj. Pastaj shkarjet që bëhen në trajtat morfologjike të fjalëve në tekstet e detyrave, ia humbin kuptimin detyrës dhe me këtë nuk mund të arrihen rezultatet e kërkuara.

6 Gjyshi dhe gjyshja kanë të njëjtën moshë. Nëse i mbledhim vitet e tyre, vitin e kaluar ata kishin 140 vjet. Vitin e ardhshëm ata do të kenë gjithsejtë të 144 vjet.

a) Sa vjet kanë gjithsejtë këtë vit?

b) Sa vjet ka secili prej tyre këtë vit?

Ilustrim. Matematika për klasën e katërt, f.62.

¹⁰⁶ Udhëzues kurrikular lëndor për gjuhën shqipe, Material ndihmës për mësuesit e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Tiranë, 2018, f.14.

¹⁰⁷ Po aty.

Gjuha shqipe dhe shkencat e natyrës. Programi i shkencave të natyrës përfshin mënyra stimuluese dhe aktive për përfitimin e shkathtësive në shkencë duke mundësuar qasje aktive ndaj të mësuarit e shkencave natyrore. Gjatë vëzhgimit të shqipes në këto libra, nxorëm disa shembuj për të dëshmuar parregullsitë që evidentuam. Po japim vetëm një shembull si ilustrim:

“Ti je unikat. Nuk ka pasur kurrë, por nuk do të ketë ndonjë i njëjtë si ti. Ti i përngjan prindërve të tu, por ti je shumë i veçantë. Rritesh dhe ndryshon, por edhe si gjallesat e tjera, mund të hash dhe të lëvizësh. Një ditë ndoshta mund të bëhesh prind. Edhe fëmijët e tu do të jenë unikatë.¹⁰⁸

Siç mund të shihet, teksti është përkthyer nga maqedonishtja dhe në shqip ka shumë gabime. Së pari mund të jetë përkthyer me google translate ose nga ndonjë përkthyes që fare nuk e di sintaksën e shqipes. Fjala unikat, në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe nuk ekziston fare. Në shqip kemi fjalën unik-e, që është vetëm një, që s’ka tjetër të ngjashëm me të; që takohet shumë rrallë; i vetëm. Rast unik. Kjo fjalë është lënë në maqedonisht.

E dyta, fjalitë nuk janë formuluar në pajtim me sintaksën e shqipes. Po shihet qartë se është një përkthim i fjalëpërfjalshëm nga maqedonishtja. *Nuk ka pasur kurrë, por nuk do të ketë një i njëjtë si ti.* (që duhet të jetë: *Nuk ka pasur dhe nuk do të ketë njeri që do të jetë i njëjtë si ti ose Nuk ka pasur dhe kurrë nuk do të ketë ndonjë të njëjtë si ti*). Në fjalinë tjetër kemi të shkruar gabim trajtën e shkurtër të përemrit vetor. *Ti i përngjan prindërve të tu* në vend ti **u përngjan** prindërve.

Gjuha shqipe dhe historia. Në librat e historisë nxënësit marrin njohuri të vërtetuara shkencore për të kaluarën. Përfitojnë njohuri për të arriturat e përgjithshme civilizuese në botë dhe e thellojnë interesimin për mësimin e mëtutjeshëm të proceseve dhe ngjarjeve historike. Mësojnë dhe thellojnë njohuritë për të kaluarën e atdheut të tyre dhe zhvillojë atdhedashurinë për vendlindjen dhe kombin e tyre. Moszbatimi i normës së standardit të shqipes në këto libra si pasojë e përkthimeve të mangëta, ka shkaktuar shpeshherë edhe gabime që lidhen me luftëra, me beteja, me vende ku janë zhvilluar betejat, data të gabuara historike e kështu me radhë. Gabimet e këtilla pastaj shtrembërojnë fakte dhe ngjarje të rëndësishme historike.

Gjuha shqipe dhe shoqëria. Libri i shoqërisë është një udhëzues i cili i njofton nxënësit dhe i pasuron njohuritë e tyre për vendin ku jetojnë, për karakteristikat e tij, për të kaluarën historike, për trashëgiminë kulturore, për institucionet etj. I njofton për të drejtat themelore të njeriut, të drejtat e fëmijëve, por edhe të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve të vendit. Përmes kësaj lënde, nxënësit njoftohen për shumë gjëra rreth botës dhe problemeve aktuale botërore. Gjatë analizës së librave të shoqërisë, hasëm gabime gjuhësore të natyrave të ndryshme si: përkthim të fjalëpërfjalshëm me sintaksë nga maqedonishtja, mospërshtatje të emrave në rase, gabime në shkrimin e emrave të vendeve dhe gabime të tjera të natyrave të ndryshme.

Po japim një shembull:

Flamuri i Republikës së Maqedonisë (mungon e Veriut) është i kuq. Nga mesi i saj, deri në skaje të flamurit, është i shpërndarë dielli me tetë rrezet e saja.¹⁰⁹

Liqeni i Ohrid është liqeni më i madh natyror në Republikën e Maqedonisë.

Gjuha shqipe dhe gjeografia. Moszbatimi i standardit dhe mospërdorimi i terminologjisë adekuate në librat e gjeografisë, te nxënësit krijon vështirësi në zbërthimin e drejtë të përkufizimeve, përdorimin e literaturës plotësuese dhe hamendje për dukuritë identike që trajtohen në lëndët tjera.¹¹⁰ Shembujt në vazhdim janë dëshmi e një qasjeje joserioze e personave kompetent në përpilimin e këtij teksti.

¹⁰⁸ *Shkencat natyrore për klasën 3*, Ars Lamina, 2018.

¹⁰⁹ https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Opstestvo_5_alb.pdf, f. 10, (marrë më 28.03.2022).

¹¹⁰ Bashkim Idrizi, “Terminologjia joadekuate dhe gabimet gjuhësore në librat e gjeografisë në gjuhën shqipe”, *Scupi* 31, Shkup, 2021.

Vendbanimet e para dhe aktivitetet e njerëzve kanë ndodhni në brezin e nxehtë, në afërsi të Ekuatorit. Kushtet e volitshme klimatike, si dhe vegjetacioni i zhvilluar, kanë qenë burime konstante të ushqimit, për banorja më të hershme të planetit tonë. Me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e mjeteve, njerëzit kanë filluar t'i banoja edhe brezat e mesem të nxehtësisë.¹¹¹

Ose

...Toka ka formë të parregullt të rrumbullakët, gjeqjesisht formë elipsoide.¹¹²

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, gabimet drejtshkrimore në kombinim me terminologjinë joadekuatë dhe përkufizimet e gabuara, bëjnë që këto libra të jenë të dëmshëm për procesin mësimor pasi japin një pasqyrë jo të saktë për temën e trajtuar. Përveç kësaj, disa libra të gjeografisë kanë pasur përmbajtje me prapavijë politike, ofenduese dhe kanë shtrembëruar historinë e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Gjatë analizës së teksteve të tjera, gabime vërehen edhe në përdorimin e trajtave të shkurtra të përemrit vetor, të nyjës së përparme, në përshtatjen e gjymtyrëve përemërore e mbiemërore me emrin përgjegjës etj. Gabime hasen edhe në përdorimin e shenjave të pikësimit: gjenden ku s' duhen ndërsa mungojnë aty ku e kanë vendin.

Përfundimi

Duke u nisur nga fakti se gati të gjitha tekstet shkollore me mësim në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut janë të përkthyer nga tekste me autorë maqedonas, mund të konstatojmë se mangësitë dhe niveli i ulët i standardit të shqipes në këto tekste, vjen si pasojë e përkthimeve të mangëta dhe joprofesionale nga maqedonishtja. Në bazë të rezultateve të fituara nga analiza e bërë, vijmë në përfundim se tekstet shkollore vuajnë nga një varg problemesh, defektesh dhe mangësish, të cilat janë mjaft shqetësuese dhe me të cilat duhet të merren urgjentisht personat dhe organet kompetente e përgjegjëse, në mënyrë që tekstet shkollore të pastrohen sa më parë nga këto të meta, të cilat nuk duhet të jenë veçori e teksteve shkollore cilësore.

Në mënyrë të përmbledhur do të mund të thuhej se bazuar në arritjet e këtij studimi, ndër problemet dhe të metat më të mëdha gjuhësore të teksteve shkollore, janë:

- Tekste të përkthyer fjalë për fjalë, gjë që e bën tekstin të palogjikshëm dhe të pakuptueshëm;
- Përdorimi i madh i fjalëve të huaja si rezultat i mosnjohjes adekuate të gjuhës standarde shqipe nga ana e përkthyesit;
- Tekste shqipe që tingëllojnë me një sintaksë në maqedonisht;
- Shkarje në drejtshkrimin e zanoreve, grupeve të zanoreve, diftongjeve, apostrofit, bashkëtingëlloreve e grupeve të bashkëtingëlloreve, takimi i dy shkronjave të njëjta, përdorimi i shkronjës së madhe, nyjës së përparme, shkrimi i datave etj;
- Gabime në trajtën e shumës të emrave dhe të mbiemrave;
- Mospërshtatje të emrave në rasa;
- Gabime në shkrimin e disa pjesëzave dhe parafjalëve etj.

Nëse rilindësit na e lanë trashëgim gjuhën shqipe dhe shkollën kombëtare, detyra jonë si studiues është ta ruajmë dhe ta zhvillojmë atë edhe më tej, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e kohës. Prandaj, përveç detyrimit kombëtar, dashurisë ndaj gjuhës dhe detyrës për komunikim të saktë e të drejtë, ne studiuesit e gjuhës, duhet të jemi gardianët e saj dhe gjithmonë në anën e mbrojtjes, afirmimit dhe përparimit e përdorimit të standardit të saj.

¹¹¹ https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Geografija_VI_alb.pdf, f.143, (marrë më 29.03.2022).

¹¹² Po aty f. 31.

Të shpresojmë që riaktualizimi i këtyre çështjeve do të shërbejë si alarm për autorët e teksteve dhe të mekanizmave të tjerë përgjegjës që të ndërmarrin masat e duhura për të bërë përmirësimet e nevojshme në tekstet shkollore, në mënyrë që tekstet shkollore njëherë e mirë të zhvishen nga këto probleme e të meta dhe rrjedhimisht të kryejnë sa më mirë funksionin dhe misionin e tyre për të cilin janë të dedikuara.

Referencat

- [1]. *110 vjet Alfabet shqip*, Scupi, Vëllimi 23, Shkup, 2018.
- [2]. *75-vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore*, Scupi, Vëllimi 17, Shkup, 2017.
- [3]. *Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1973.
- [4]. *Gjendja e arsimit në vend – sfidat dhe perspektivat*, Scupi, Vëllimi 30, Shkup, 2020.
- [5]. *Gjuha dhe shkolla shqipe në Maqedoninë e Veriut*, Scupi, Vëllimi 31, Shkup, 2020.
- [6]. *Gjuha shqipe në Maqedoni – histori dhe perspektiva*, Scupi, Vëllimi 22, Shkup, 2018.
- [7]. *Kongresi i Drejtshtkrimit të Gjuhës Shqipe*, vepër me vlera të mëdha kombëtare, Scupi, Vëllimi 2, Shkup, 2012.
- [8]. Lloshi, Xhevat. *Rreth alfabetit të shqipes*. Shkup: Logos A, 2008.
- [9]. *Propozime për drejtshtkrimin*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare, Shkup, 2022.
- [10]. <https://docplayer.gr/87647807-Universiteti-fan-s-noli-fakulteti-i-edukimit-dhe-i-filologjise-korce-akademia-jubilar-me-rastin-e-40-vjetorit-te-kongresit-te-drejtshtkrimit.html> (qasje me datë 22.03.2022)
- [11]. <https://dokumen.tips/reader/f/problem-et-dhe-te-metat-e-teksteve-shkollore> (qasje me datë 22.03.2022)
- [12]. https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2019/08/Koncepcija_za_izrabotka_na_ucebnik-alb.pdf (qasje me datë 30.03.2022)
- [13]. <https://shitegu.com/archives/21715> (qasje me datë 26.03.2022)
- [14]. <https://tradita.org/2020/01/26/gjuha-e-teksteve-shkollore-te-kimise-te-arsimit-fillor-ne-maqedoni/> (qasje me datë 27.03.2022).
- [15]. Lievesly, Tara. Herridge, Deborah. *Shkencat natyrore për klasën 3*. Shkup: Ars Lamina, 2018.
- [16]. Lievesly, Tara. Herridge, Deborah. *Shkencat natyrore për klasën 3, Fletore pune*. Shkup: Ars Lamina, 2018.
- [17]. Ливсли, Тара. Хериџ, Дебора. *Природни науки за 3 одделение*. Скопје: Арс Ламина, 2019 год.
- [18]. Lievesly, Tara. Herridge, Deborah. *Shkencat natyrore për klasën 2, Fletore pune*. Shkup: Ars Lamina, 2019.
- [19]. Anthony Russel. *Shkencat natyrore për klasën 1, Fletore pune*. Shkup: Ars Lamina, 2018.
- [20]. Anthony Russel. *Shkencat natyrore për klasën 1*. Shkup: Ars Lamina, 2018.
- [21]. Morison, Karen. *Matematika për klasën e tretë*. Shkup: Ars Lamina, 2019.
- [22]. Morison, Karen. *Matematika për klasën e tretë, Fletore pune*. Shkup: Ars Lamina, 2019.
- [23]. Морисон, Карен. *Математика за трето одделение*. Скопје: Арс Ламина, 2019 год.
- [24]. Morison, Karen. *Matematika për klasën e parë, pjesa e parë*. Shkup: Ars Lamina, 2018.
- [25]. Morison, Karen. *Matematika për klasën e parë, pjesa e dytë*. Shkup: Ars Lamina, 2018.
- [26]. Morison, Karen. *Matematika për klasën e parë, pjesa e tretë*. Shkup: Ars Lamina, 2018.
- [27]. <https://www.e-biblioteka.gov.mk/books/022/> (marrë më 24.03.2022)
- [28]. <https://e-biblioteka.gov.mk/books/012/> (marrë më 24.03.2022)
- [29]. <https://e-biblioteka.gov.mk/books/011/> (marrë më 24.03.2022)
- [30]. <https://e-biblioteka.gov.mk/books/021/> (marrë më 24.03.2022)
- [31]. <https://e-biblioteka.gov.mk/books/020/> (marrë më 24.03.2022)
- [32]. <https://e-biblioteka.gov.mk/books/005/> (marrë më 24.03.2022)
- [33]. https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Geografija_VI_alb.pdf (marrë më 29.03.2022).
- [34]. https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Opstestvo_5_alb.pdf (marrë më 28.03.2022).